



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Irena Plaku** (anëtare)
6. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
7. **Ridvan Hado** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Markelian Koça** (anëtar)
10. **Emona Muçi** (anëtare)
11. **Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Ali{...} Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWWI/INL.*
7. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 17.04.2024. Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje për 10 çështje. Nëse nuk kemi diskutime mbi përmbajtjen e rendit të ditës, do sugjeroja të fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} me qëllim gradimi, periudha 2013-2016. Relatore është zonja Emona Muçi shkurtimisht nga ana e relatores të prezantohet projektraporti.

Emona Muçi: Faleminderit!

Në mënyrë të shkurtuar, të përmbledhur, në lidhje me raportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezultoi se procedura e vlerësimit të gjyqtares {...} ka filluar me vendimin nr.81, datë 16.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit. Me këtë vendim, pas shortit të

realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: relator z. Ridvan Hado; nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datën 17.02.2023, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019, gjyqtarja është njoftuar për fillimin e procedurës së vlerësimit, për vlerësuesit e përzgjedhur dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre. Në datën 20.02.2023, gjyqtarja ka konfirmuar marrjen dijani, duke mos parashtruar kërkesë për përjashtimin e vlerësuesit, ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

Me procesverbalin e datës 26.06.2023, nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin, bazuar në pikën 24 të vendimit nr. 197, 11.06.2020, ka evidentuar çështjet dhe vendimet që janë administruar në dosjen e rivlerësimit të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit.

Me urdhrin e datës 27.06.2023, relatori ka disponuar në lidhje me shortin për përcaktimin e kategorive të çështjeve dhe përzgjedhjen e dosjeve të tjera.

Bazuar në urdhrin e relatorit, në datën 30.06.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti dhe nuk ka shfaqur pretendime në lidhje me procedurën e shortit.

Me vendimin nr. 91, datë 20.02.2024, “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduar nga z.Ridvan Hado”, është zëvendësuar relatori për shkak të papajtueshmërisë ligjore që ekziston mes qenies si anëtar në dy komisione dhe është zëvendësuar me relatoren znj. Emona Muçi. Ky vendim i është njoftuar gjyqtarës e cila është deklaruar se nuk ka asnjë pretendim.

Pas administrimit të 6 dosjeve të përzgjedhura me short, ka filluar hartimi i projektraportit.

Me vendimin e datës 06.03.2024, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP), pasi gjeti të plotë dokumentacionin e dosjes së vlerësimit, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit, me njoftimin e projektraportit të vlerësimit me qëllim gradimi.

Projektraporti vlerësimit i është njoftuar gjyqtarës në adresën e saj elektronike në datën 06.03.2024, e cila në datën 11.03.2024 konfirmoi marrjen dijani, si dhe gjatë periudhës 2-javore nuk parashtroi kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit. Në lidhje me mbledhjen plenare ajo ka dijani sipas konfirmimit me e-mailin e paraqitur dhe të sjellë përpara kësaj mbledhjeje.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit është pasqyruar në mënyrë të plotë në projektraportin e vlerësimit dhe për të mos u zgjatuar në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave - Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, analizën dhe vlerësimin individual të tyre, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete dhe për këtë arsye në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material penal, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe vetëm në një rast ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Nuk evidentohet një analizë e veçantë e normave të ligjit, (teorike dhe e pavarur nga fakti penal objekt shqyrtimi), gjyqtarja referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, duke bërë zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, e në vijim nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” duhet të vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundëson lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se përgjithësisht, gjyqtarja paraqet një analizë të strukturuar të fakteve të çështjes, identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, e aplikon atë mbi faktet e çështjes dhe parashtron argumentet mbi mënyrën e zbatimit të ligjit, duke lidhur këto argumente me konkluzionet e arritura mbi kërkimet objekt padie, pretendimet e palëve, apo konkluzionin e saj mbi çështjet penale të shqyrtuara.

Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtarja i kushton një vëmendje më të posaçme arsyetimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, arsyetimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Në këto vendime, ligji material dhe dispozitat procedurale referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, duke u lidhur menjëherë me konkluzionin e arritur, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe integrimin e tij me argumentet e gjyqtarës mbi faktet e çështjes.

Pavarësisht peshës së arsyetimit ligjor, e cila nuk është e njëjtë në të gjitha vendimet e analizuara, në çdo rast mënyra e organizimit dhe paraqitjes së analizës së faktit dhe ligjit, si dhe argumentimit, përmban lidhjen logjike shkak-pasojë, mes çështjeve të shtruuara për zgjidhje, referuar objektit të padisë civile ose objektit të çështjes penale, me konkluzionet e arritura nga gjyqtarja. Kjo lidhje në disa vendime vjen si pasojë e aplikimit të drejtpërdrejtë të ligjit të zbatueshëm mbi faktet e provuara në gjykim dhe në disa prej vendimeve vjen si pasojë e një analize më të plotë mbi interpretimin dhe

dhënien e arsyeve të mënyrës së zbatimit të ligjit mbi faktet, në shërbim të konkluzioneve të arritura.

Në konkluzion, cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush në përgjithësi standardet e procesit të rregullt ligjor, si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin e gjyqtares. Analiza jo e plotë dhe e detajuar e provave të marra në gjykim me qëllim evidentimin e faktit penal, nuk i jep cilësi analizës dhe argumentimit logjik. E njëjta shkallë aftësie konstatohet edhe në aspektin e arsytimit të mënyrës se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara. Ky proces i dytë i metodologjisë së të shkruarit të mendimit juridik, bazohet më shumë në deduksione logjike, sesa në analizë ligjore. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për Kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares” është 90 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

2. Kriteri “Aftësitë organizative të gjyqtares”

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë. 2.A.a Respektimi i afateve ligjore - Nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për vetëm 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit. Konkretisht:

(i) Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë. Referuar vendimit nr. 344, datë 04.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 02.10.2014 dhe datë vendimi datën 04.10.2014. Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se edhe kjo çështje rezulton që të jetë përfunduar brenda afatit ligjor për përfundimin e saj, rezulton se raporti i

shprehur në përqindje është 0% të çështjeve jashtë afatit ligjor. Referuar sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej afatit ligjor, është 0%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohet afat ligjore shqyrtimit, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish-KLD-së. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues, duhet të vlerësohet “0-10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori të çështjeve të marra në analizë, rezulton se:

(i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet e kategorisë “Penale krime”, rezulton të jetë rreth 45 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale krime në gjykatën e shkallës së parë.

(ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet e kategorisë “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 135 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm në gjykatën e shkallës së parë.

Pra referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për të gjitha kategoritë e çështjeve ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Për këtë arsye, vlerësoj se gjyqtarja për këtë tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 324 çështje nga të cilat 21 çështje civile të përgjithshme, 117 çështje penale, 32 kërkesa penale, 138 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi dhe përgjime) dhe 16 kërkesa civile, ose 131 çështje me palë kundërshtare sipas standardit.

Referuar të dhënave të pasqyruara në vërtetimin nr. {...} prot., datë 19.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit, shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve:

- Në vitin 2014, i janë caktuar si çështje të reja 62 çështje, ka përfunduar 48 çështje;

- Në vitin 2015, i janë caktuar 145 çështje, ka përfunduar 157 çështje;

- Në vitin 2016, i janë caktuar 132 çështje, ka përfunduar 128 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës 08.10.2013-08.20.2016, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2014-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 333 çështje, me çështjet e caktuara 339, në masën 98,2%.

Duke konsideruar faktin që në vitin 2014 gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 4 muaj, treguesit statistikorë për këtë periudhë nuk mund të japin të dhëna të sakta për treguesin e rendimentit, duke qenë se gjyqtarja ka filluar punë në muajin shtator dhe për pasojë ka ushtruar detyrën për vetëm 4 muaj. Për rrjedhojë, çështjet e caktuara nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 4 muaj, kohë kjo e barabartë ose më e shkurtër se standardi minimal kohor për kategorinë çështjeve penale (krime dhe kundërvajtje). Rrjedhimisht, treguesit e vitit 2014 nuk mund të merren në konsideratë në përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve dhe kjo përlllogaritje do të bëhet mbi të dhënat statistikore të viteve të plota të ushtrimit të detyrës, 2015 dhe 2016.

Duke iu referuar numrit të çështjeve të përfunduara, me ato të caktuara për secilin vit, rezulton se:

Për vitin 2015, gjyqtarës i janë caktuar 145 çështje dhe ka përfunduar 157 çështje. Për pasojë rendimenti është 108%;

Për vitin 2016, gjyqtarës i janë caktuar 132 çështje dhe ka përfunduar 128 çështje. Për pasojë rendimenti është rreth 97%;

Për të dy vitet së bashku, rendimenti mesatar i përfundimit të çështjeve është 103%, tregues i cili sipas Metodologjisë, pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyesimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar çështjeve burim vlerësimi të ndarë sipas kategorive, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë” është 2.5 ditë, më e shkurtër se afati 10-ditor; (ii) për kategorinë “Çështje penale krime”, është 4.6 ditë, më e shkurtër se afati 10-ditor.

Pra, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar është më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë tregues vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, pra me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë (çështje penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 9 seanca gjyqësore. Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë” numri mesatar i seancave gjyqësore është 6 seanca gjyqësore dhe (ii) për çështje të kategorisë “Penale krime” numri mesatar është 2.7 seanca gjyqësore.

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtarë të analizuara, rezulton të jetë 3.4 seanca gjyqësore.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 (vetëm në çështjet civile të përgjithshme), vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata, si dhe aktet e paraqitura nga palët. Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

3.A Etika në punë, 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe

nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares, 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është i paanshëm dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar nga palët për përjashtimin e gjyqtares duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4.A Aftësia e komunikimit, 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Edhe në lidhje me këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të këtyre parimeve dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit, për pasojë vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me këtë tregues duhet të vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar, 4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë, e për pasojë vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë, e për pasojë vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në vërtetimin me nr. {...} prot., datë 21.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se gjyqtarja {...}, ka qenë pjesëmarrës në 6 aktivitete trajnuese të organizuara nga kjo shkollë, të zhvilluara në 9.5 ditë trajnimi.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese apo kohëzgjatjen minimale të këtij angazhimi. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtares në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtarja vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional, si pasojë për këtë tregues gjyqtarja {...} duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për

përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera, për këtë arsye vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është 91 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtares, 90 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.
 2. Aftësitë organizative të gjyqtares, 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.
 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.
 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, “Shkëlqyeshëm”.
- Vlerësimi i përgjithshëm, 381 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatores.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi për gjyqtaren {...}, për periudhën 2013-2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 381 pikë.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |
| 11. Yllka Rupa | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
7. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që edhe ky ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Irena Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...} për periudhën 2017-2019. Procedura e vlerësimit ka filluar me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021 të KLGJ-së si pjesë e programit të miratuar me vendimin nr. 645, datë 23.12.2020. Fillimisht është caktuar si relatore anëtarja {...}, për shkak të mbarimit të mandatit të saj me vendimin jam caktuar un për zëvendësimin e anëtares dhe të nëpunëses. Është njoftuar gjyqtari për relatoren dhe nëpunësen përgjegjëse. Nuk ka pasur kundërshtime.

Pasi është gjetur i plotë dokumentacioni pjesë e procesit të vlerësimit dhe është depozituar nga nëpunësja përgjegjëse raporti analitik i vlerësimit, depozituar në datën

18.01.2024, është gjetur e plotë procedura dhe është filluar me hartimin e projektraportit.

Shkurtimisht po kaloj tek kriteret e vlerësimit dhe në konkluzionet përkatëse duke qenë se jeni njohur me projektraportin e vlerësimit ashtu edhe me raportin analitik, të cilat janë përshkruar në mënyrë të detajuar.

Sa i përket treguesit të parë 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave - Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshëm të fakteve të çështjes, për çështje të cilat gjyqtari arrin nëpërmjet analizës së integruar më vete dhe tërësisë së normave pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi i së cilës bën në mënyrë të shprehur duke iu referuar konkluzioneve të analizës së tij mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira të gjyqtarit në identifikimin e normës dhe normave konkrete procedurale dhe materiale në aktet ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi objektin e shqyrtimit. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete, por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përjasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu gjyqtari referon edhe ligjet specifike dhe interpreton ato. Në funksion të interpretimit referon edhe

vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, jurisprudencën e këtyre gjykatave, të kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të zbatuar, referuar dhe kur është rasti për të analizuar aspektet të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtari ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ në mbështetje të argumenteve të tij. Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej tij për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet në çdo rast, duke filluar me prezantimin e fakteve, duke e gërshetuar me provat e lejuara për shqyrtim, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të tij të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke i ndarë me paragrafë, të cilat vijnë në rrjedhë kronologjike dhe logjike midis njëri-tjetrit, megjithëse nuk i ndanë të gjitha vendimet në nënpjesë me fjali përshkruese, nga përmbajtja e tyre identifikohet qartë secila pjesë e tij. Në disa

vendime konstatohet që janë të ndarë me nëntituj dhe disa të tjerë megjithëse nuk janë të ndarë në nëntituj, secila pjesë identifikohet qartë dhe vendimet janë të ndarë në paragrafë të cilat vijnë në rrjedhë logjike ndërmjet tyre.

Në tërësi referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme më shumë në aspektin e përmbajtjes, por jo atë vizual (pjesa më e madhe e vendimit është ndarë vetëm në paragrafë dhe jo në tituj apo fjali hyrëse përshkruese), por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, dhe në disa raste për të mbështetur interpretimin e tij ka referuar në qëndrimeve të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara kryesisht për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë është pikët 100 dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”.

Lidhur me 2.A.a Respektimin e afateve ligjore, sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 206 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 99 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Raporti i çështjeve të cilat janë shqyrtuar në raport me çështjet të cilat kanë parashikuar afat ligjor, rezulton në masën 48% të çështjeve jashtë afatit. Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Është bërë edhe një herë llogaritja e afateve ligjore të dosjeve duke zbritur lejen vjetore të gjyqtarit, festat e fundvitit, afatet e mbartjes së dosjes. Pas rilllogaritjes ka rezultuar se tashmë nga 99 çështje, 61 çështje më sipër do konsiderohen të përfunduara në afat ligjor. Sa më sipër ka rezultuar se nga 206 çështje rezulton se vetëm 18.4 % e tyre janë shqyrtuar në tejkalim të afatit që sipas metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit lidhur me këtë tregues është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë tjetër pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave të burimeve të vlerësimit. Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se për periudhën e vlerësimit gjyqtari ka gjykuar 1741 çështje, nga të cilat 1104 çështje janë me palë kundërshtare dhe 637 çështje pa palë kundërshtare.

Referuar standardit sasior të përcaktuar në vendimin 261/2 të ish-KLD-së rezulton se standardi ka qenë 151 çështje me palë kundërshtare dhe gjyqtari e ka tejkaluar këtë standard në masën 145 %.

Referuar sa më sipër, nga analiza e të dhënave, duke marrë parasysh numrin e çështjeve për të cilën është tejkaluar, nuk është respektuar afati ligjor i gjykimit me numrin total të çështjeve për të cilat ligji ka parashikuar afat e cila ka rezultuar në 18.4%, raportin e çështjeve të caktuara.. numrin total të çështjeve të shqyrtuara nga ana e gjyqtarit si dhe për një afat 3 vjet ka gjykuar 1741 çështje duke kaluar standardin minimal me 145%, vlerësoj se duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi duke arritur në nivelin maksimal prej 15 pikësh.

Sa i përket 2.A.b Plotësimit të standardeve minimale kohore.

Referuar afatit njëmuajor në ish-vendimin e KLD-së rezulton se shumica e çështjeve janë në tejkalim të këtij afati. Por duke pasur parasysh ligjin 49 të 2012 është

bërë një rillogaritje e afatit/standardit minimal pasur parasysh momentet procedurale të cilat duhet të zbatohen nga ana e gjyqtarit, ka rezultuar se afati standard që duhet të përfundojë një çështje është 87 ditë. Nga analizimi i burimeve të të dhënave, duke marrë në konsideratë këtë afat prej 87 ditësh ka rezultuar se janë gjithsej 659 çështje që do përlllogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do zbriten numrit 815 (814 sipas raportit) të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur 155 çështje të shqyrtuara jashtë këtij afati, si standard minimal. Referuar çështjeve për të cilat parashikohet standard minimal rreth 814, nga të cilat rezultojnë 155 që janë shqyrtuar në tejkalim të këtij standardi, rezulton se 10 % e çështjeve nuk është zbatuar standardi minimal, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 5 pikë. Sa më sipër, duke qenë se përqindja matematikore rezulton me pikëzimin maksimal, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtari do vlerësohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje (i) për kategorinë “Çështje administrative me palë kundërshtare” është 60.75 ditë (më e shkurtër se 87 ditë); (ii) për kategorinë “Çështje administrative pa palë kundërshtare” është 8.2 ditë; dhe (iii) për kategorinë “Marrëdhënie pune” është 86 ditë. Pra të gjitha kategoritë e çështjeve janë shqyrtuar brenda standardit minimal pra janë më të shkurtra se standardi minimal prej 87 ditësh. Për sa më sipër edhe për këtë tregues gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar raportit analitik rezulton se raporti mes numrit të çështjeve të përfunduara (1741), me numrin e çështjeve të caktuara brenda periudhës së vlerësimit (1851), është 94%, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë. Referuar metodologjisë së pikëzimit pasur parasysh aspektin sasior, rezulton se gjyqtari e ka tejkaluar standardin sasior për çdo vit në masën 145 %, pasi ka gjykuar 1104 çështje me palë kundërshtare ose 654 çështje më shumë seç është parashikuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së.

Referuar sa më sipër për pikëzimin e këtij treguesi vlerësohet që gjyqtari të pikëzohet me një nivel më të lartë sa i përket të dhënave statistikore duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit.

Koha mesatare e arsytimit të vendimit për të gjitha kategoritë e çështjeve ka rezultuar më e shkurtër se afati procedural i parashikuar prej 7 ditësh, konkretisht për çështjet me palë kundërshtare ka rezultuar 2.2 ditë, për çështjet pa palë kundërshtare 1.5 ditë, për çështjet marrëdhënie pune 2.3 ditë. Sa më sipër për këtë tregues gjyqtari vlerësohet në pikëzimin maksimal prej 15 pikësh, pasi koha mesatare e arsytimit të vendimit ka rezultuar më e shkurtër se afati procedural.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore, ka rezultuar se numri mesatar i seancave është 2 seanca gjyqësore. Gjithashtu ka rezultuar se gjyqtari kryen veprime të nevojshme procedurale për administrimin e procesit me qëllim shmangien seancave joproduktive. Referuar sa më sipër për këtë tregues, duke qenë se numri i seancave është 2 seanca dhe gjyqtari të gjitha çështjet (me palë kundërshtare) ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë të tyre është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Kjo vihet re edhe nga numri i paket i seancave por edhe shqyrtimi i çështjeve brenda standardeve minimale kohore.

Sa i përket treguesit saktësia dhe plotësia e dokumentacionit rezulton se gjyqtari shkallë shumë të lartë aftësie për këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezulton mungesë e dokumentacionit apo prania e dokumentacionit që nuk i përket dosjeve. Edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative” është pikët 100 niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

3.A Etika në punë, 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në tërësi, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën e tij. Referuar sa më sipër vlerësohet për këtë kriter aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit, 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Edhe për këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë për cenimin e integritetit të gjyqtarit. Për sa më sipër vlerësohet aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nuk rezultojnë të dhëna për përdorimin e gjuhës diskriminuese. Për sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë.

Sa i përket 3.C.b Numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, rezulton se ky numër është i pakonsiderueshëm, konkretisht rezulton referuar raportit analitik që janë paraqitur 9 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e tij. Gjithashtu rezulton se ka paraqitur 22 kërkesa për heqje dorë dhe nga të cilat janë pranuar 17. Referuar sa më sipër vlerësohet ky numër është i pakonsiderueshëm duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e tretë është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Kriteri i katërt 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente për këto arsye propozohet pikëzimi i tij me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe për rrjedhojë prezumohet që gjyqtari ka treguar kujdes maksimal. Referuar sa më sipër për këtë tregues vlerësohet aftësia e tij shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar, bashkëpunimi me kolegët por edhe me

administratën, për të dyja këto tregues rezultojnë aftësia e tij shumë e lartë duke e pikëzuar me pikët maksimale, me 15 dhe 10 pikë për secilin nga këto tregues.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarëve në programet e formimit vazhduesh të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Rezultojnë referuar raportit analitik dhe konkretisht shkresës nr. {...} prot., datë 28.07.2021 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, rezultojnë se ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhduesh në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese gjithsej 25 ditë trajnimi (brenda kufijve të përcaktuar në metodologjinë e pikëzimit). Sa më sipër propozohet pikëzimi i tij me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht vërtetimit nr.{...} prot., datë 09.01.2024 lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës pasqyrohet se është angazhuar në cilësinë e magjistratit udhëheqës në praktikën profesionale të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2017-2020, ku ka udhëhequr praktikën profesionale për magjistrat {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Referuar sa më sipër për këtë tregues, duke qenë se rezultojnë angazhimi i tij për të udhëhequr kandidatët për magjistratë, propozohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun. Nga burimet e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit 2017-2019 në dosjen e gjyqtarit apo të dhëna nga burimet e vlerësimit, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale.

Në lidhje me këtë tregues gjyqtari në datë 09.01.2024, me shkresën e protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor po në këtë datë, në kuadër të procesit të vlerësimit periodik ka paraqitur dy dokumente, konkretisht vërtetimin e lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës mbi mentorimin e disa studentëve të Shkollës së Magjistraturës si dhe ftesë për pjesëmarrje në konferencën me temë “13 vjet eksperiencë e politikës së Konkurrencës...”. Gjithashtu në lidhje me po këtë tregues, me shkresën e protokolluar me nr.{...} prot., datë 11.01.2024, në kuadër të procesit të vlerësimit ka paraqitur dokumente

që i përkasin pjesëmarrjes së tij në një konferencë me temë “Workshop...”, të zhvilluar në datat 09-10 tetor 2017.

Lidhur me këtë tregues, pasur parasysh parashikimet e parashikuara në metodologjinë e vlerësimit është vlerësuar... Në lidhje me dokumentat e paraqitura nga gjyqtari në kuadër të procesit të vlerësimit, që vërtetojnë pjesëmarrjen e tij në një Workshop të organizuar nga një organizatë ndërkombëtare, vlerësoj se këto të dhëna tregojnë angazhimin e gjyqtarit në një aktivitet trajnues jashtë Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluar nga një organizatë ndërkombëtare, në rang rajonal dhe nuk tregojnë kontributin e tij personal në këtë veprimtari ndërinstitucionale që kanë pasur si qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, p.sh. fjalime, pjesëmarrje në konferenca shkencore, etj. Pra vlerësohet si pjesëmarrja në veprimtari të tilla, pjesëmarrja aktive e gjyqtarit për përmirësimin e sistemit gjyqësor, duke dhënë kontributin e tij dhe jo thjeshtë pjesëmarrje, për të përfituar vetë gjyqtari nga një veprimtari e tillë. Pra bazuar në sa më sipër është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime duke depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor ankim protokolluar me nr. {...}, datë 06.03.2024 ku bashkëngjitur ka paraqitur vërtetimin me nr. {...} protokollin, datë 06.03.2024 lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas të cilës vërtetohet se z. {...} për periudhën 2017-2019 ka dhënë kontributin në propozimin e temave të aktiviteteve trajnuese, kontribut ky që përkon me fazën e përgatitjes së kalendarit të aktiviteteve trajnuese për Programin e Trajnimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Referuar sa më sipër, kësaj prove të paraqitur nga ana e gjyqtarit, si dhe referuar Metodologjisë së Pikëzimit (bashkëpunimi i Këshillit me përmirësimin e programit të formimit vazhdues), propozoj pikëzimin e tij tashmë jo me tre pikë por me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Nuk rezultojnë publikime akademike të gjyqtarit, për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 0 pikë.

Propozimi sipas raportit të vlerësimit ka qenë 93 pikë. Pasur parasysh edhe këtë vërtetim, propozoj 95 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi në tërësi është si më poshtë:

110 pikë për kriterin e parë, 100 pikë për “Aftësitë organizative”, 100 pikë për “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” 95 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Vlerësimi i përgjithshëm, 395 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Jemi dakord me propozimin e bërë nga relatorja bashkë me konsiderimin e rritjes së dy pikëve për kriterin? Nëse po kalojmë në votim në tërësi me gjithë reflektimin nga ana e relatores.

Nuk ka diskutime. Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 395 pikë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

10. Emona Muçi (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
- 7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Pa humbur kohë kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Relator z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit znj. Kryetare!

Këshilli pasi ka hapur ndërmjet të tjerave vendet vakante me vendimet e datës 20.02.2024 për lëvizjet paralele në gjykatat e shkallës së parë Tiranë dhe Durrës kryen në vijim verifikimin e kriterëve formale për kandidatët që kanë kandiduar për këto vende.

Një ndër kandidatët është edhe zonja {...}

Në lidhje me kriteret e kandidimit.

Referuar nenit 43, pika 6 e Ligjit për Statusin, ka rezultuar se zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2003, ka përfunduar pranë Universitetit “Justiniani I” ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca Juridiko-Penale në vitin 2011 dhe Master Shkencor në “Legjislacioni dhe Institucionet Europiane” pranë Institutit të Studimeve Europiane, UT në vitin 2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendimin nr. 480, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.

Me vendimin nr. 521, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “Me Urdhër Nr.{...} prot., datë 05.01.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, është urdhëruar që gjyqtarët e Gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë, do të gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve pa ndarje në dhoma civile, penale si dhe në seksionin tregtar dhe familjar.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, sipas urdhrit të Këshillit të Gjykatës, ajo ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe çështje të natyrës penale.

Nga të dhënat e administruara ka rezultuar se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me

vendimin e nr. 86, datë 20.02.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi

Në kriterin tjetër ligjor që gjen pasqyrim në nenin 8, pika 2 të ligjit “Për statusin”, është bërë verifikimi përkatës duke marrë deklaratën e saj dhe verifikimet që kemi bërë ne si Komision dhe ka rezultuar se ajo nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Ndodhur në këto kushte ne propozojmë që të vijojnë procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e nr. 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Nëse s’kemi diskutime, vazhdojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

10. Emona Muçi (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
- 7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Sërish e ka fjalën z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Në lidhje me pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024 të KLGJ për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka shprehur interesin e tij edhe kandidati z. {...}. Edhe për këtë kandidat, referuar nenit 48 të ligjit “Për statusin” Komisioni paraprakisht bëri verifikimin e tre kritereve formale ligjore nga të cilat ka rezultuar, në lidhje me vjetërsinë e tij si magjistrat dhe vjetërsinë minimale në fushën e specifike kanë rezultuar këto të dhëna: zoti {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit European të Tiranës në datën 25.07.2012. Ai ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca penale pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

Me vendimin nr. 11, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet magjistrat profili gjyqtar.

Me vendimin nr. 54, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Me vendimin nr. 99, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë 1 (një) vjeçare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Durrës.

Me vendimin nr. 103, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm për një periudhë 1 (një) vjeçare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Durrës, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidatin: “Z. {...} për periudhën janar 2020, deri në mars 2023 si gjyqtar i kësaj gjykate ka shqyrtuar të gjitha kategoritë e çështjeve (civile dhe penale). Pranë Gjykatës Sarandë nuk ka ndarje në seksione, por janë krijuar vetëm trupat gjykuese dhe të gjithë gjyqtarët gjykojnë të gjitha kategoritë e çështjeve që u vijnë për shqyrtim”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidatin z. {...}, ai aktualisht rezulton të jetë pjesë e dhomës penale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit.

Nuk rezulton që të ketë masë disiplinore në fuqi.

Referuar nenit 8, pika 2 të ligjit “Për statusin” është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” në rast të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe rezulton si nga deklarata e tij ashtu edhe nga verifikimet tona, rezulton që në rastin e lëvizjes paralele ai nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

Ndodhur në këto kushte ne i propozojmë Këshillit kualifikimin e këtij kandidati dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele të tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 05/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

- | | |
|--------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
- 7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 05/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Rusi.

Ilir Rusi: Në referim edhe të përvojave të mëparshme të Këshillit në këto raste, ju është vënë në dispozicion relacioni i hollësishëm në lidhje me pasqyrimin e fakteve dhe rrethanave dhe veprimet procedurale të kryera deri më tani, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të hollësishme tek seksioni “fillimi i procedimit disiplinor”, tek seksioni që ka të bëjë me “zhvillimin e hetimit disiplinor”, tek seksioni në lidhje me “faktet dhe rrethanat e pretenduara objekt të procedimit disiplinor”, tek seksioni “shkeljet disiplinore të pretenduara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë”; në vijim po të këtij relacioni janë pasqyruar edhe faktet dhe rrethanat e procedurës tek seksioni i pestë “procedura e verifikimit paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor”; dhe duke iu referuar seksionit të fundit që është seksioni numër gjashtë që ka të bëjë me “shqyrtimin nga Komisioni”, në vlerësim të këtyre rrethanave dhe fakteve, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e tij të datës 15.04.2024, pasi dëgjoji relatorin (që isha unë), u njoh me relacionin e hartuar nga ana ime, si dhe me aktet e ndodhura në dosjen hetimore, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...}, ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Sa u parashtrua, në kushtet kur nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për mbylljen e procedimit disiplinor, në cilësinë e relatorit, i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore, e cila, si rregull, duhet të zhvillohet brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra nga data 05.04.2024. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin 15-ditor të njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

Në eventualitet të miratimit të propozimit për të kaluar çështjen në seancë dëgjimore, sipas referimit të datave, data e mundshme është data 2 maj 2024, ditë e enjte.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet:

1. Caktimi i datës 2 maj, ora 11:00 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen dhe rishpërndarjen e disa automjeteve, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Irena Plaku** (anëtare)
6. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
7. **Ridvan Hado** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Markelian Koça** (anëtar)
10. **Emona Muçi** (anëtare)
11. **Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
8. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen dhe rishpërndarjen e disa automjeteve, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në dy akte që janë të Komisionit të Administrimit të Buxhetit. E para ka të bëjë me shpërndarjen dhe rishpërndarjen e disa automjeteve, në sistemin gjyqësor.

Kemi këtu Drejtorin e Departamentit të Buxhetit i cili shkurtimisht do na i relatojë të dy projekt-aktet.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Gjatë vitit buxhetor 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, realizoi procedurën e blerjes së 10 (dhjetë) automjeteve, për nevojat e sistemit gjyqësor, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë bërë hyrje në magazinë.

Kërkesë për automjete, në vitin 2023 gjatë përgatitjes së dokumentit të PBA 2024-2026, ka paraqitur Gjykata e Lartë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Shkallës Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Gjatë vitit 2023, Gjykatës së Lartë iu dërguan 4 automjete, nga të cilat siç jeni në dijeni 2 i morën në dorëzim kurse 2 automjete të tjera nuk i tërhoqën por ato iu transferuan Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila kishte paraqitur një kërkesë për 7 automjete.

Në shkurt të vitit 2024 edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka paraqitur kërkesë për 2 automjete.

Ndërsa gjatë përgatitjes së PBA 25-27 faza parë, kanë paraqitur kërkesa për automjete, Gjykata e Lartë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykata Administrative Tiranë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë vitit 2024, Gjykatës së Posaçme së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, iu dërguan 2 automjetet të cilat nuk u pranuan nga Gjykata e Lartë, nga 7 automjete që ajo kishte kërkuar.

Kështu, struktura përgjegjëse për administrimin e aktiveve në KLGJ, bazuar në të dhënat që disponon dhe në një analizë të situatës aktuale të mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor si dhe kërkesave të sipërcituara, si dhe pas konsultimit të bërë me përfaqësuesen e Gjykatës së Lartë për nevojat që ajo kishte, vlerëson propozimin për shpërndarjen e 10 automjeteve të reja për vitin 2024 përkatësisht Gjykata e Lartë 3 automjete, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 1 automjet, Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 1 automjet, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë 1 automjet dhe në dispozicion të KLGJ 4 automjete, si dhe rishpërndarjen e 12 automjeteve të përdorura, (aktualisht në përdorim nga Gjykatë e Lartë, e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe KLGJ), propozohet për t'iu dërguar 1 automjet Gjykatës së

Lartë, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 4 automjete, Hyundai Elantra viti 2019 dhe 7 automjetet e tjera të kalojnë përkohësisht në dispozicion të KLGJ të cilat pas vlerësimit të tyre do të shpërndahen sipas nevojave të gjykatave të tjera.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi shpërndarjen dhe rishpërndarjen e disa automjeteve në sistemin gjyqësor, sipas pasqyrës nr. 1 dhe pasqyrës nr.2 bashkëlidhur. Faleminderit!

Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e shpërndarjes së 10 automjeteve të reja dhe rishpërndarjen e 12 automjeteve të përdorura, sipas pasqyrës nr. 1 dhe pasqyrës nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, Gjykata e Lartë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme Shkalla e Parë

për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
8. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës. Edhe ky është projekt-akt i cili ka të bëjë me rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024. Për më shumë detaje sërish ia jap fjalën Drejtorit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Me shkresën nr. 1851, datë 11.04.2024, Gjykata e Lartë, ka paraqitur kërkesën për transferim (rishpërndarje) fondi në shpenzime kapitale për shkak të një situatë jo të

zakonshme që u krijua në këtë gjykatë nga rënia e zjarrit në katin e katërt të kësaj godine. Për këtë arsye ka dalë nevoja e domosdoshme kryerja e disa ndërhyrjeve shtesë në godinën e kësaj gjykate. Gjykata ka paraqitur dhe preventivin e punimeve sipas materialit i cili është bashkëlidhur.

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor për vitin 2024, i ndarë në tre programe buxhetore, pjesë e të cilës është edhe Gjykata e Lartë në programin buxhetor 03310 “Buxheti Gjyqësor”.

Për Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u detajuan fondet buxhetore për vitin buxhetor 2024, në shpenzime kapitale (investime) në kodin e projektit 18AD501 “Blerje pajisje zyre” në shumën 4,500 mijë lekë.

Duke vlerësuar rëndësinë dhe emergjencën, Gjykata e Lartë për përmirësimin e kushteve të godinës, kërkon rishpërndarjen e fondeve duke pakësuar fondet në kodin e projektit “Blerje pajisje zyre” dhe duke shtuar fondet në kodin e projektit “Rikonstruksion godine”, në shumën 3,800 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore, në programin 03310, në shpenzime kapitale (investime), për Gjykatën e Lartë, duke pakësuar fondet në kodin e projektit 18AD801 “Blerje pajisje zyre” dhe duke shtuar fondet në projektin M290068 “Rikonstruksion i pjesshëm”, në shumën 3,800 mijë lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (investime), për Gjykatën e Lartë, për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të afatit të komandimit të nëpunësve përgjegjës për vlerësim znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

10. Emona Muçi (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
- 7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të afatit të komandimit të nëpunësve përgjegjës për vlerësim znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Naureda Llagami: Kalojmë në pikën 8 që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të afatit të komandimit të nëpunësve përgjegjës për vlerësim znj. {...} dhe znj. {...}. Për më shumë detaje fjalën e ka znj. Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Në lidhje me pikën 8 të kësaj mbledhjeje Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në zbatim të neneve 85 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja “dh” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, bazuar në programet e vlerësimeve për vitet 2021 dhe 2023, miratuar me vendimet nr.645, datë 23.12.2020 dhe nr.561, datë 29.12.2022, po vijon procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022, për 21 gjyqtarë, nga të cilët për 2 prej tyre Komisioni ka vendosur pezullimin e procedurave të vlerësimit. Për 19 procedurat e tjera të vlerësimit të cilat vijojnë ende, rezulton se në 5 prej tyre ka qenë nëpunës përgjegjës për vlerësim znj. {...}1 dhe në 13 prej tyre ka qenë nëpunës përgjegjës për vlerësim znj. {...}.

Në zbatim të nenit 171, pika 5 të ligjit për statusin dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimet nr. 81, datë 16.02.2023, nr. 523, datë 05.10.2023 dhe nr. 725, datë 07.12.2023, Këshilli ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për 39 gjyqtarë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Me këto vendime, janë caktuar nëpërmjet procedurës së shortit, relatori dhe nëpunësi përgjegjës për secilin gjyqtar. Për 6 nga këto procedura të filluara dhe të papërfunduara rezulton se për 2 prej tyre ka qenë nëpunës përgjegjës për vlerësim znj. {...} dhe për 4 të tjera ka qenë znj. {...}.

Gjithashtu, për të gjithë gjyqtarët të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, apo për gjyqtarët që kanë kandiduar në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, Këshilli ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për 12 gjyqtarë, si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin. Procedurat vijojnë ende për 5

gjiqtarë, ku për 2 prej tyre kanë qenë nëpunës përgjegjës për vlerësim znj.{...} dhe znj.{...}.

Ndërkohë që zhvilloheshin procedurat e mësipërme të vlerësimit, Këshilli, me vendimin nr.17, datë 18.01.2024, ka vendosur përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj.{...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.01.2024. Po kështu, Këshilli me vendimin nr.98, datë 29.02.2024 ka vendosur përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj.{...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 02.03.2024.

Lidhur me caktimin dhe zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në nenin 12, pika 2 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 parashikohet se: “Bazuar në listën e mësipërme, mbledhja plenare e Këshillit cakton me short relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës...”.

Në këto kushte është e nevojshme caktimi i një nëpunësi përgjegjës të ri në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara prej tyre, konkretisht në 6 procedura gradimi; 2 procedura vlerësimi të përsheptuar, 13 procedura vlerësimi për periudhën 2017-2019, si dhe 4 procedura vlerësimi për periudhën 2020-2022.

Në zbatim të nenit 12 të vendimit të Këshillit nr.263, caktimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësimi duhet të bëhet me short ndërmjet nëpunësve përgjegjës aktuale të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, konkretisht znj.Erlanda Agaj, znj.Merita Karaj dhe znj.Anjeza Buzo. Duke marrë në konsideratë prioritetet në vlerësime dhe shpërndarjen e barabartë të punës midis nëpunësve të vlerësimit, Komisioni i propozon Mbledhjes Plenare organizimin e 2 procedurave të veçanta shortimi për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësim.

Në procedurën e parë të organizohet shorti për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2017-2019, 2020-2022 dhe në procedurat e përsheptuara të detyruar për vitin e fundit kalendarik (2021 dhe 2022):

1. {...} – vlerësim 2017-2019;
2. {...}– vlerësim 2017-2019;
3. {...}– vlerësim 2017-2019;
4. {...}– vlerësim 2017-2019;
5. {...} – vlerësim 2017-2019;
6. {...}– vlerësim 2017-2019;
7. {...}– vlerësim 2017-2019;
8. {...}– vlerësim 2017-2019;
9. {...}– vlerësim 2017-2019;
10. {...}– vlerësim 2017-2019;
11. {...}– vlerësim 2017-2019;
12. {...}– vlerësim 2017-2019;
13. {...}– vlerësim 2017-2019;
14. {...}– vlerësim 2020-2022;
15. {...}– vlerësim 2020-2022;
16. {...}– vlerësim 2020-2022;
17. {...}– vlerësim 2020-2022;
18. {...}– vlerësim 2020-2022;
19. {...}– vlerësim i përshpejtuar i detyruar viti 2022;
20. {...}– vlerësim i përshpejtuar i detyruar viti 2021.

Në procedurën e dytë të organizohet shorti për për zgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar: 1. {...}, 2. {...}, 3. {...}, 4. {...}, 5. {...}, 6. {...}.

Në procedurën e shortimit do të marrin pjesë me një shpërndarje të barabartë pune, për aq sa është e mundur nëpunësit përgjegjës aktuale të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional znj.Erlanda Agaj, znj.Merita Karaj dhe znj.Anjeza Buzo. Në një vazo më vete duhet të vendosen në procedurën e parë të shortit shiritat me emrin e secilës prej nëpunësve përgjegjëse, gjithsej 20 shirita (7 për znj.Erlanda Agaj, 6 znj. Anjeza Buzo dhe 7 për znj.Merita Karaj). Në procedurën e dytë të shortit duhet të vendosen në një vazo më vetë 3 shirita letre me emrin e secilës nëpunëse, gjithsej 6 shirita (2 për secilën

nëpunëse). Në shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve në proces vlerësimi, të cilët duhet të vendosen në një vazo tjetër për secilën procedurë shorti, duhet të shkruhet veç emrit të tyre edhe procedura e vlerësimit në të cilën përzgjidhet me short nëpunësi përgjegjës, pasi ka gjyqtarë të përfshirë njëkohësisht në më shumë se 1 procedurë vlerësimi.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin “Për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të afatit të komandimit të nëpunësve përgjegjës për vlerësim znj.{...} dhe znj.{...}”.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, konkretisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, konkretisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2020-2022 (*lapsus viti i përmendur nga relatorja 2022-2023*), konkretisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësim, në procedurën e papërfunduara të përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti i fundit kalendarik, konkretisht për gjyqtarët {...} dhe {...}.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë kalojmë tek stafi i cili të përgatisë procedurën e shortit sipas udhëzimeve të projektvendimit.

Procedura e shortit si vijon:

Në një enë futet shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, {...}, {...}.

Në enën e dytë futen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj. Erlanda Agaj (7 shirita), znj. Merita Karaj (7 shirita), znj. Anjeza Buzo (6 shirita).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Emri i parë përzgjidhet z. {...} (4.b.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i dytë përzgjidhet z. {...} (2.a.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i tretë përzgjidhet znj. {...} (4.a.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i katërt përzgjidhet z. {...} (2.k.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i pestë përzgjidhet znj. {...} (3.a.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i gjashtë përzgjidhet z. {...} (3.d.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i shtatë përzgjidhet znj. {...} (2.h.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i tetë përzgjidhet z. {...} (2.m.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i nëntë përzgjidhet znj. {...} (2.f.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i dhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.c.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i njëmbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.d.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i dymbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.1.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i trembëdhjetë përzgjidhet z. {...} (2.g.). Për gjyqtarin {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i katërbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (3.c.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i pesëmbëdhjetë përzgjidhet z. {...} (2.b.). Për gjyqtarin {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i gjashtëmbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (3.b.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i shtatëmbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.i.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i tetëmbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.e.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i nëntëmbëdhjetë përzgjidhet znj. {...} (2.j.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i njëzetë përzgjidhet znj. {...} (3.e.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Procedura e shortit të dytë si vijon:

Në enën e parë futen shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në enën e dytë futen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: Erlanda Agaj (2 shirita), Merita Karaj (2 shirita), Anjeza Buzo (2 shirita).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Emri i parë përzgjidhet z. {...} (1.d.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i dytë përzgjidhet z. {...} (1.b.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Emri i tretë përzgjidhet znj. {...} (1.e.). Për gjyqtaren {...} -nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i katërt përzgjidhet znj. {...} (1.c.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Emri i pestë përzgjidhet znj. {...} (1.f.). Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Emri i gjashtë përzgjidhet z. {...} (1.a.). Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, me nëpunësin përgjegjës për vlerësim, si më poshtë:

- a) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- b) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- c) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;

- d) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- e) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- f) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo.

2. Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, me nëpunësin përgjegjës për vlerësim, si më poshtë :

- a) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- b) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- c) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- d) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- e) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- f) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- g) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- h) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- i) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- j) Për gjyqtaren {...}- nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- k) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- l) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- m) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj.

3. Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2020-2022, me nëpunësin përgjegjës për vlerësim, si më poshtë :

- a) Për gjyqtaren {...}- nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;
- b) Për gjyqtaren {...}- nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- c) Për gjyqtaren {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Merita Karaj;
- d) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim Anjeza Buzo;
- e) Për gjyqtaren {...}- nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj.

4. Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim në procedurën e papërfunduara të përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti i fundit kalendarik, si më poshtë:

- a) Për gjyqtaren {...}- nëpunës përgjegjës për vlerësim Erlanda Agaj;

b) Për gjyqtarin {...}-nëpunës përgjegjës për vlerësim znj. Merita Karaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23, datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e fundit sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
- 7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23, datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër që ka të bëjë me fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve, që ka të bëjë edhe kjo me hedhjen e shortit, për lëvizjet paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë, Juridiksionit i Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura nga Këshilli.

Kështu që pa shumë vonesa ia kaloj fjalën relatorit z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Fillimisht janë hapur disa pozicione në proces me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për lëvizjet paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës dhe më pas me vendimet e fundit të këtij viti janë hapur disa pozicione të lira të përhershme me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës. Nisur nga ecuria e proceseve të verifikimit të kriterëve formale, më tej Komisioni po vijon veprimtarinë e tij duke sjellë ditën e sotme relacionin përkatës që ka të bëjë me përcaktimin e relatorit dhe fillimin e procedurës së përzgjedhjes për kandidatët në lëvizjet paralele në pozicionet që unë i përmenda më lart.

Konkretisht në datë 24.05.2023, me vendimin nr. 249, ndër të tjera Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan.

Afati i kandidimit ishte deri më datë 14.06.2023.

Me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime/ 1 vlerësim/ pa vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë.

Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 249 dhe 252 të vitit 2023.

Në pozicionin nr. 249 kandidat i vetëm me një vlerësim ishte z. {...}. Këshilli me vendimin nr. 463/2023 ndër të tjera ka vendosur: “Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249.”

Me disa vendime të datës 18.01.2023 (*lapsus data 11 relativ nga z. Kurushi*), Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi 14 (katërbëdhjetë) procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to, me vendimin nr. 22 dhe nr. 23, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në pozicionin nr. 22 kandidat i kualifikuar është me 1 (një) vlerësim është znj. {...}, pasi Këshilli me vendimin nr. 333/2023 vendosi, ndër të tjera, kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22/2023. Në pozicionin nr. 23 (pra të vendimit që është marrë në të njëjtën datë), kandidat i vetëm i kualifikuar është z. {...}, pasi Këshilli me vendimin nr. 332/2023 vendosi kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23.

Me disa vendime të datës 20.02.2024 (pra bëhet fjalë për këtë vit), Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi 14 (katërbëdhjetë) procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to, me vendimin nr. 82-86, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, konkretisht pozicionet nr. 82 - nr. 84 (fusha civile) dhe pozicionet nr. 85 – nr. 86 (fusha penale).

Në të gjitha këto pozicione ka kandidatë të kualifikuar, qoftë me 2 (dy) vlerësime, apo me 1 (një) vlerësim.

Pozicioni nr. 82 - fusha civile, kualifikuar znj. {...};

Pozicioni nr. 83 - fusha civile, kualifikuar z. {...};

Pozicioni nr. 83 - fusha civile, kualifikuar z. {...};

Pozicioni nr. 85 - fusha penale, kualifikuar z. {...};

Pozicioni nr. 86 - fusha penale, kualifikuar kandidatët z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Me disa vendime të datës 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë hapur 14 (katërbëdhjetë) procedura të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të

Përgjithshëm, ndër to, me vendimet nr. 73-nr.81, procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile e penale, konkretisht pozicionet nr. 73-79 fusha civile, pozicionet nr. 80-81, fusha penale.

Në të gjitha këto pozicione ka kandidatë të kualifikuar, me 2 (dy) vlerësime.

Pozicioni nr. 73 - kandidati z. {...} dhe znj. {...};

Pozicioni nr. 74 - kandidatja znj. {...};

Pozicioni nr. 75 - fusha civile, kandidatja znj. {...};

Pozicioni nr. 76 - kandidatja znj. {...};

Pozicioni nr. 77 - kandidati z. {...};

Pozicioni nr. 78 – janë të kualifikuar kandidatët z. {...} dhe znj. {...};

Pozicioni nr. 79 - fusha civile, kandidatja znj. {...};

Pozicioni nr. 80 - fusha penale, janë të kualifikuar kandidatët z. {...}, znj. {...}, znj. {...};

Pozicioni nr. 81 - fusha penale, janë të kualifikuar kandidatët {...}, {...}, {...}.

Propozimet e Komisionit

Sa më sipër, rezulton që në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan/Durrës dhe Tiranë, të ketë kandidatë të kualifikuar për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, ku shumica e të cilëve kanë kandiduar për tre pozicione të lira, në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji, pika 5, e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pika nr. 75 e vijim të Kreut VI parashikohet ndër të tjera se: “Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre. 76. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.”

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për kandidatët për lëvizjet paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë për pozicionet e përmendura më lart.

Sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele. Lidhur me këtë, sipas projektvendimit, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë 17 pozicione të lira, është propozuar që secili nga anëtarët e Komisionit të jetë relator për 5 pozicione, ndërsa Kryetari i Komisionit të jetë relator në 7 të tjera.

Sa i përket relatorit për këto procedura përzgjedhjeje të lëvizjes paralele, ai duhet të zgjidhen me short ndërmjet 3 (tre) anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për pozicionet përkatëse sipas përcaktimeve në pikën 13 të këtij relacioni.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika, të cilat janë bërë të ditura dhe vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve. Unë s'po i lexoj edhe një herë. Faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë administrata të nisë procedurën e hedhjes së shortit.

Procedura e hedhjes së shortit:

Në një enë futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi (i cili do të jetë relator për 7 nga pozicionet); z. Alban Toro (i cili do të jetë relator për 5 nga pozicionet); z. Markelian Koça (i cili do të jetë relator për 5 nga pozicionet).

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës ku e cituar është numri i pozicionit: pozicioni nr. 249, 24.05.2023; pozicioni nr. 22, 18.01.2023; pozicioni nr. 23, 18.01.2023; pozicioni nr. 73, 20.02.2024; pozicioni nr. 74, 20.02.2024; pozicioni nr. 75, 20.02.2024; pozicioni nr. 76, 20.02.2024; pozicioni nr. 77, 20.02.2024; pozicioni nr. 78, 20.02.2024; pozicioni nr. 79, 20.02.2024; pozicioni nr. 80, 20.02.2024; pozicioni nr. 81,

20.02.2024; pozicioni nr. 82, 20.02.2024; pozicioni nr. 83, 20.02.2024; pozicioni nr. 84, 20.02.2024; pozicioni nr. 85, 20.02.2024 dhe pozicioni nr. 86, 20.02.2024.

Procedura e përzgjedhja si vijon:

Relatori i parë i përzgjedhur është z. Alban Toro, i cili do të jetë relator për 5 nga pozicionet e përzgjedhura si vijon: pozicioni nr. 76, 20.02.2024, pozicioni nr. 80, 20.02.2024, pozicioni nr. 84, 20.02.2024, pozicioni nr. 78, 20.02.2024, pozicioni nr. 85, 20.02.2024.

Relatori i dytë i përzgjedhur është z. Markelian Koça, i cili do të jetë relator për 5 nga pozicionet e përzgjedhura si vijon: pozicioni nr. 75, 20.02.2024, pozicioni nr. 73, 20.02.2024, pozicioni nr. 83, 20.02.2024, pozicioni nr. 249, 24.05.2023, pozicioni nr. 81, 20.02.2024.

Relatori i tretë i përzgjedhur është z. Klodian Kurushi, i cili do të jetë relator për 7 nga pozicionet e përzgjedhura si vijon: pozicioni nr. 22, 18.01.2023, pozicioni nr. 77, 20.02.2024, pozicioni nr. 86, 20.02.2024, pozicioni nr. 74, 20.02.2024, pozicioni nr. 82, 20.02.2024, pozicioni nr. 79, 20.02.2024, pozicioni nr. 23, 18.01.2023.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2.Caktimin e relatorit për këto procedura përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes sipas numrit të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:

a. Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76, 20.02.2024, nr. 80, 20.02.2024, nr. 84, 20.02.2024, nr. 78, 20.02.2024, nr. 85, 20.02.2024 – relator do të jetë z. Alban Toro.

b. Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 75, 20.02.2024, nr. 73, 20.02.2024, nr. 83, 20.02.2024 dhe nr. 249, 24.05.2023 – relator do jetë z. Markelian Koça. *(nga shorti më lart rezulton që edhe z. Koça do të jetë relator edhe për pozicionin nr. 81, 20.02.2024, të cilin gabimisht zonja Llagami e lexon si pozicion të përzgjedhur për relatorin z. Kurushi. Për saktësim, korrigjohet dhe referohet edhe një herë në fund të mbledhjes. Shih Procesverbalin e pikës së fundit.).*

c. Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 81, 20.02.2024, nr. 22, 18.01.2023, nr. 77, 20.02.2024, nr. 86, 20.02.2024, nr. 74, 20.02.2024, nr. 82, 20.02.2024, nr. 79, 20.02.2024, nr. 23, 18.01.2023 – relator do të jetë z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 17.04.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi):

10.1 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...};

10.2 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:35 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 6. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI/INL.*
7. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të projektit EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi):

10.1 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...};

10.2 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}.

(Largohet nga salla e mbledhjes z. Markelian Koça.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit që edhe kjo ka të bëjë me fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar për vlerësimin etik dhe profesional, periudha e vlerësimit për vitin kalendarik 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në këtë vendimmarrje z. Markelian Koça nuk do jetë pasi ka papajtueshmëri.

Kalojmë në relatimin e projekt-aktit.

Emona Muçi: Në lidhje me këtë relacion.

Pas mbarimit të afatit të aplikimit për të gjitha pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Administrative të Apelit, është zhvilluar procedura e verifikimit dhe janë plotësuar kushtet për disa nga kandidatët për të cilët Këshilli me vendime të ndryshme ka vlerësuar plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit për 18 nga kandidatët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në katër pozicione në gjykatën administrative të apelit dhe nëntë pozicione në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e së drejtës civile, konkretisht për znj. {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Nga ana e këtij Komisioni janë mbajtur në vëmendje nenet 97, të ligjit “për statusin”, është mbajtur në vëmendje neni 21 në lidhje me disa ndryshime, pra ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, vendimin e Këshillit me nr. 263, datë 21.11.2019 në lidhje me mundësinë e vlerësimit të përshpejtuar dhe ka dalë në konkluzionet se për gjyqtarët:

(i) znj. {...}, e cila ka kandiduar më herët për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit, rezulton se Këshilli i Lartë Gjyqësor përkatësisht me vendimin nr.154, datë 14.04.2021, ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar të gjyqtares për periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2019. Në momentin e rikandidimit të gjyqtares në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (maj 2023), ka kaluar më shumë se 2-vjet nga vlerësimi i fundit, afat i cili në kuptim të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe nenit 22 të vendimit nr. 263, përbën kusht për fillimin përsëri të një vlerësimi të përshpejtuar. Por duke qenë se për këtë gjyqtare ka dy vlerësime të

mëparshme të realizuara tashmë nga Këshilli, një vlerësim i zakonshëm (3-vjeçar, periudha e gradimit) dhe një i përshpejtuar (viti 2019), Komisioni vlerëson se në përputhje me nenin 48, pika 9 të Ligjit për Statusin dhe me pikën 78 të vendimit nr. 70, datë 07.02.2020: “Për çdo kandidat, me përjashtim të atij që ka qenë në një pozicion të komanduar në vitin e fundit kalendarik, si vlerësim i dytë për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, konsiderohet ai i bërë sipas Ligjit të Statusit dhe rregullave të parashikuara në nenin 22, Kreu V, të Vendimit të Këshillit nr.263, datë 21.11.2019, nuk mund të kryejë një vlerësim tjetër të përshpejtuar për të. Në rast se do të vlerësonim se gjyqtarës do t’i bëhej edhe një vlerësim tjetër i përshpejtuar, kjo do të sillte si pasojë konkurrimin e më pas ngritjen e tyre në detyrë me dy vlerësime të përshpejtuara, rregull që bie në kundërshtim me parimin e ngritjes në detyrë të përcaktuar në dispozitat e mësipërme, ku përcaktohet se për ngritjen në detyrë kërkohet domosdoshmërisht që gjyqtari të ketë dy vlerësimeve të zakonshme dhe në pamundësi të tyre, realizimin e një vlerësimi të përshpejtuar, çka nënkupton që një vlerësim duhet të jetë i zakonshëm (3 apo 5-vjeçar).

(ii) Për gjyqtaren {...}, e cila ka kandiduar për ngritje në detyrë në dy pozicione të lira në fushën penale, janë miratuar raportet e vlerësimit.

(iii) Për gjyqtarin {...}, i cili ka aplikuar më parë dhe Këshilli me vendimin nr.377, datë 13.07.2023 ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2013-2016, si dhe është ende në proces vlerësimi i përshpejtuar.

(iv) Për gjyqtaret {...} dhe {...} Këshilli i Lartë Gjyqësor më herët, me vendimet nr. 177, datë 29.04.2021 dhe nr.371, datë 13.09.2022 ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe aktualisht këto gjyqtare janë në procedurë vlerësimi, i cili do të përbëjë vlerësimin e dytë, për efekt renditjeje.

(v) Për gjyqtaren {...}, e cila ka aplikuar më parë për ngritje në detyrë gjithashtu ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit dhe vlerësimit për periudhën e vlerësimit 10.02.2020 - 21.11.2022.

(vi) Për gjyqtaren {...}, tashmë gjyqtarja ka dy vlerësime.

(vii) Për gjyqtaret {...} dhe {...}, Këshilli, për efekt të këtij kandidimi për ngritje në detyrë, me vendimin nr.179, datë 03.04.2024 ka filluar tashmë procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022. Gjithashtu

me vendimet nr. 81, datë 16.02.2023 dhe nr. 725, datë 07.12.2023 ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, të cilat janë ende në proces.

(viii) Për gjyqtaren {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.428, datë 14.10.2022 ka vendosur përfundimin pa vendimi përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Për këtë gjyqtare me vendimin nr.371, datë 13.09.2022 Këshilli ka filluar dhe është në proces të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019. Në kushtet e mësipërme, për këtë gjyqtare e cila ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe është konfirmuar në detyrë, ka një vlerësim, atë 3-vjeçar 2017-2019, ndërsa vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i vitit kalendarik 2022.

(ix) Për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, përkatësisht me vendimet, nr. 81, datë 16.02.2023, nr. 523, datë 05.10.2023 dhe nr. 725, datë 07.12.2023 ka vendosur fillimin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Procedurat e vlerësimit për periudhën 2013-2016 vijnë ende për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, ndërkohë për gjyqtaren {...} vlerësimi ka përfunduar me miratimin e raportit të vlerësimi për vitet 2013-2016 me vendimin nr.160, datë 03.04.2024. Për gjyqtaren {...} gradimi do të fillojë pas dërgimit të dosjes nga organet e rivlerësimit. Për këta gjyqtarë, gradimi përbën vlerësimin e parë për efekt të renditjes. Ndërsa vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar i vitit të fundit kalendarik, viti 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Ndërkohë gjyqtarja {...} është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 254, datë 04.06.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe nga kjo datë deri në konfirmimin e saj në detyrë me vendimin nr.35, datë 22.09.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ajo nuk ushtruar detyrën e gjyqtares, pasi ka qenë e pezulluar. Kështu, periudha e plotë dhe e fundit 1-vjeçar që ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares përpara kandidimit për ngritjen në detyrë është viti 2019.

Referuar kuadrit ligjor të mësipërm, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar për 8 nga

gjqtarët që kanë plotësuar tre kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit dhe konkretisht (i) fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyrua për vitin kalendarik 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...} dhe (ii) fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}.

Fillimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar është i mundur për këta gjyqtarë, pasi nga viti 2016, kur përfundon periudha e vlerësimit të parë për efekt të ngritjes në detyrë, deri në vitin 2019, ka kaluar më shumë se 2 vjet, afat i cili në kuptim të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe nenit 22 të vendimit nr. 263, përbën kusht për fillimin e një vlerësimi të përshpejtuar.

Komisioni ka vlerësuar që procedurat e vlerësimit për gjyqtaren {...} duhet të fillojnë me një akt më vete, për shkak të periudhës së ndryshme të vlerësimit. Ajo do të fillojë nga 1 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional i përshpejtuar i detyruar për periudhën e vlerësimit 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 për gjyqtaren {...}, si dhe ai për periudhën e vlerësimit 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022, për shtatë gjyqtarët e tjerë do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 mbi sa më lart.

Komisioni ka përgatitur dy projektvendime:

Projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}”, të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë për pozicionet e shpallura me vendimet nr.235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, datë 24.05.2023.

Në pikën e parë të këtij projektvendimi përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2022 - 31.12.2022, për gjyqtarët e mësipërm.

Në pikën e dytë të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili zhvillohet nëpërmjet shortit, i cili për përcaktimin e relatorit do të zhvillohet midis anëtarëve të përhershëm të Komisionit, si dhe anëtarit zëvendësues të këtij Komisioni znj.Gentiana Muçaj dhe për përcaktimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin ndërmjet tre nëpunësve të Njësisë së

Vlerësimi Etik dhe Profesional, sipas nenit 12, pika 2 (të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”).

Projektvendimi “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, e cila ka plotësuar kriteret.

Lidhur me procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar për të cilën duhet të fillojë procedura e vlerësimit, duke marrë në konsideratë ngarkesën aktuale, 3 anëtarët e përhershëm të Komisionit znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa, si dhe të përfshihet në short anëtari gjyqtar zëvendësues znj. Gentiana Muçaj.

Me qëllim ruajtjen e një ngarkese të barabartë pune midis relatorëve propozohet që të përfshihen në dy procedura vlerësimi secila prej anëtareve. Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve që do të angazhohen propozohet të përfshihet në short NPV znj. Merita Karaj dhe znj. Erlanda Agaj, me një ngarkesë prej tre vlerësime secila dhe znj. Anjeza Buzo, me dy vlerësime.

Në lidhje me realizimin e shortit, do të vendosen 8 shirita letre me emrin e secilit gjyqtar për të cilin do të fillojë procedura e vlerësimit, në një enë tjetër 8 shirita letre me emrat për secilin anëtar të Komisionit (2 për znj. Emona Muçi, 2 për znj. Yllka Rupa, 2 për znj. Irena Plaku dhe 2 për znj. Gentiana Muçaj) dhe në një enë tjetër, do të vendosen 8 shirita letre me emrin e nëpunësës përgjegjës për vlerësim (3 për znj. Erlanda Agaj, 3 për znj. Merita Karaj dhe 2 për znj. Anjeza Buzo). Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen fillimisht të emrit të gjyqtarit dhe më pas të vlerësuesve.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi me botimin në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Kalojmë tek administrata.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë emrat e kandidatëve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë emrat e relatorëve: dy shirita letre me emrin e znj. Emona Muçi; dy shirita letre me emrin e znj. Irena Plaku; dy shirita letre me emrin e znj. Gentiana Muçaj dhe dy shirita letre me emrin e znj. Yllka Rupa.

Në enën e tretë të qelqit futen me radhë emrat e nëpunësve përgjegjës: tre shirita letre me emrin e znj. Erlanda Agaj, tre shirita letre me emrin e znj. Merita Karaj, dy shirita letre me emrin e znj. Anjeza Buzo.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Irena Plaku. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. Selvije Gjocaj. Përzgjidhet emri i relatores znj. Yllka Rupa. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Anjeza Buzo.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Gentiana Muçaj. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Anjeza Buzo.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Gentiana Muçaj. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Emona Muçi. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Irena Plaku. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i kandidatit z. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Emona Muçi. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i kandidatit znj. {...}. Përzgjidhet emri i relatores znj. Yllka Rupa. Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës znj. Merita Karaj.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

- Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

- Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

- Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo;

- Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim edhe tek fillimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periodua e vlerësimit viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj.

Naureda Llagami: Përpara se të largohemi, nga administrata u njoftova që kam lexuar gabim tek pozicionet e aktit të mëparshëm, pozicionet që i përkasin z. Markelian Koça, kam harruar ose ia kam thënë z. Klodian Kurushi, pozicionin nr. 81/2024. Pra thjesht për ta rikonfirmuar, që zoti Koça do të ketë si relator pozicionin 75, 73, 83, 249/2023 dhe 81/2024.

Shumë faleminderit për prezencën dhe për punën.

Mirë u takofshim.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor